



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.legjislacioni.gov.al

Nr.91

Datë 17 qershor 2014

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr. 56/2014
datë 29.5.2014

Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, e Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sh.a., si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KFW Frankfurt am Main për financimin e projektit “Linja Unazore 110 KV e Shqipërisë së Jugut”, nëpërmjet një huaje 37 750 000 euro.....

3645

Vendim i GJK
nr. 33, datë 9.6.2014

Me objekt: Ndrejje gabimi në vendimin nr. 16, datë 21.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.....

3646

LIGJ
Nr. 56/2014

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES SË HUAS
DHE PROJEKTIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCAVE, E OPERATORIT
TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT, SHA, SI
AGJENCIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT, DHE
KFW FRANKFURT AM MAIN PËR
FINANCIMIN E PROJEKTIT “LINJA UNAZORE
110 KV E SHQIPËRISË SË JUGUT”,
NËPËRMJET NJË HUAJE 37 750 000 EURO**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121,
pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të
Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndryshuese e marrëveshjes
së huas dhe projektit ndërmjet Republikës së
Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, e
Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sh.a., si
agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am
Main për financimin e projektit “Linja unazore 110
KV e Shqipërisë së Jugut”, nëpërmjet një huaje në
vlerën 37 750 000 euro.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren
Zyrtare.

Miratuar në datën 29.5.2014

**Shpallur me dekretin nr. 8591, datë 13.6.2014 të
Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

KfW Bankegruppe, Postfach 111141, 60046
Frankfurt am Main

Faks: (+355) 4 2225581

Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST)

Buleverdi “Gjergj Fishta”, nr. 10

Tiranë, Shqipëri

Në vëmendje të:

Faks: (+355) 4 222 8494

Republika e Shqipërisë

Ministria e Financave

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1

Tiranë, Shqipëri

NDRYSHIMI

I MARRËVESHJES SË HUAS NR. 24425
PËR SHUMËN PREJ 37.75 MILIONË EURO
NDËRMJET KFW DHE REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE OST E DATËS 28 DHJETOR
2009-LINJA UNAZORE 110 KV
E SHQIPËRISË JUGORE

Datë: 7.2.2014

Zona e Biznesit

KfW

f.ntwicfungsbank

Stefan Krus

Our ref: KSt

Tel: +49 69 7431-3674

Faks: +49 69 7431-2004

stefan.krus@kfw.de

Të nderuar zotërinj,

Me anë të kësaj letre i referohemi Marrëveshjes së
Huas për shumën 37.75 milionë euro (Marrëveshja e
Huas) e nënshkruar më 28 dhjetor 2009 ndërmjet
KfW-së si Huadhënës dhe Republikës së Shqipërisë si
Huamarrës dhe OST-së si Agjencia e Zbatimit të
Projektit. Nëse palët nuk vendosin ndryshe, pikat e
përcaktuara në këtë Marrëveshje Huaje kanë të njëjtin
kuptim në këtë letër.

Marrëveshja e Huas do të ndryshohet si më poshtë:

Neni 3.2 “Afatet për kërkesën e disbursimit” do të
zëvendësohet si më poshtë:

“KfW-ja mund të refuzojë disbursimet pas datës
30.6.2016.”.

Neni 6.1 “Skeduli i ripagesave” do të zëvendësohet
si më poshtë: “Humarrësi do të shlyejë huanë”, si më
poshtë:

Kësti	Data	Viti	Shuma	Euro
1	dhjetor 30	2016	2,220,588.00	euro
2	qershor 30	2017	2,220,588.00	euro
3	dhjetor 30	2017	2,220,588.00	euro
4	qershor 30	2018	2,220,588.00	euro
5	dhjetor 30	2018	2,220,588.00	euro
6	qershor 30	2019	2,220,588.00	euro
7	dhjetor 30	2019	2,220,588.00	euro
8	qershor 30	2020	2,220,588.00	euro
9	dhjetor 30	2020	2,220,588.00	euro
10	qershor 30	2021	2,220,588.00	euro
11	dhjetor 30	2021	2,220,588.00	euro
12	qershor 30	2022	2,220,588.00	euro
13	dhjetor 30	2022	2,220,588.00	euro
14	qershor 30	2023	2,220,589.00	euro
15	dhjetor 30	2023	2,220,589.00	euro
16	qershor 30	2024	2,220,589.00	euro
17	dhjetor 30	2024	2,220,589.00	euro

Aneksi 1 “Skeduli i disbursimeve” do të
zëvendësohet si më poshtë:

“Në fund të çdo periudhe të shënuar më poshtë,
Huamarrësi duhet të ketë kërkuar disbursimin e
shumave të huas, të cilat nuk do të tejkalojnë shumat e
shënuara më poshtë për çdo periudhë:

Të gjitha shifrat në euro	Të disbursuara në periudhën aktuale	Të disbursuara në periudhat e mëparshme	Disbursimet totale
01.01.2014-30.06.2014	11,800,000.00	5,715,406.27	17,515,406.27
01.07.2014-31.12.2014	11.300.000.00	17,515,406.27	28,815,406.27
01.01.2015-30.06.2015	2.350.000.00	28,815,406.27	31,165,406.27
01.07.2015-31.12.2015	2.350.000.000	31,165,406.27	33,515,406.27
01.01.2016-30.06.2016	4.234,593.73	33,515,406.27	37,750,000.00

Me nënshkrimin e kësaj letre ndryshimi dhe duke iu referuar fakteve dhe rrethanave ekzistuese, Huamarrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit përsërisin përfaqësimet dhe garancitë e parashikuara në nenin 13.1 të Marrëveshjes së Huas.

Kjo letër nuk ndryshon ndonjë dispozitë tjetër të Marrëveshjes së Huas dhe nuk përbën një dokument të heqjes dorë në lidhje me ndonjë nga të drejtat tona që rrjedhin nga Marrëveshja e Huas.

Kjo letër rregullohet nga ligji gjerman.

Lutemi jepni konfirmimin tuaj për termat dhe kushtet e kësaj letre, duke nënshkruar ku tregohet më poshtë dhe duke i kthyer një letër origjinale KfW-së.

Me respekt
KfW

Stefan Boltz

Stefan Krus

Në kopje

Ne jemi dakord me çështjet e ngritura në letrën tuaj të datës 7 shkurt 2014, e cila është në kopje.

Për dhe në emër të OST-së
Datë:

Emri:

Titulli:

VENDIM
Nr. 33, datë 9.6.2014

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar i “ “
Sokol Berberi	anëtar i “ “
Vitore Tusha	anëtare e “ “
Altina Xhoxhaj	anëtare e “ “
Fatmir Hoxha	anëtar i “ “
Besnik Imeraj	anëtar i “ “
Fatos Lulo	anëtar i “ “
Gani Dizdari	anëtar i “ “

me sekretare Blerina Basha, në datën 3.6.2014, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 27 Akti, që i përket:

3646

KËRKUES: Nazmi Luku

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Ministria e Transportit dhe e Infrastrukturës, shoqëria e përmbarimit “EPSA” sh.p.k.

OBJEKTI: Ndrejje gabimi në vendimin nr. 16, datë 21.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 80 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Gani Dizdari, shqyrtoi kërkesën e paraqitur dhe diskutoi çështjen në tërësi:

VËREN:

I

1. Kërkuesi Nazmi Luku i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese, me objekt: “Konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit brenda një afati të arsyeshëm të vendimit të formës së prerë nr. 81, datë 18.6.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë”.

2. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 16, datë 21.3.2014, ka vendosur: “Konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 81, datë 18.6.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

3. Pas zbardhjes së vendimit, kërkuesi i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese, me objekt: “Ndrejje gabimi në shkrim në dispozitivin e vendimit nr.16, datë 21.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese, duke zëvendësuar fjalët “të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë” me fjalët “të Gjykatës së Apelit Tiranë””.

II

Gjykata Kushtetuese, pasi administroi vendimin e saj nr. 16, datë 21.3.2014, konstaton se është bërë një gabim material dhe konkretisht: në dispozitivin e vendimit në vend të fjalëve “të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë” duhej të ishte shkruar “të Gjykatës së Apelit Tiranë”.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 80 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Ndrejjen e gabimit në dispozitivin e vendimit nr. 16, datë 21.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese, si vijon:
 - Në dispozitiv, në vend të “vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 81, datë 18.6.2008 të Gjykatës së

Rrethit Gjyqësor Tiranë”, do të jetë “vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 81, datë 18.6.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë”.

- Një kopje e këtij vendimi i bashkohet vendimit nr. 16, datë 21.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Sokol Berberi, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Gani Dizdari, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 8 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006